



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANUAR/DOKUZUAR: DATE RECEIVED / SUBMITTED:			
Nivoli Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
09	47	994	2



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

	Kryetarin e Komunës së Klinës Kuvendi Komunal Klinë
Kopje elektronike:	Hykmete Bajrami, Kryesuese e KMFP dhe Koordinatorë e KMFP Armend Muja, Kryesues i KBPT dhe Koordinator i KBPT
Nga:	Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm, Republika e Kosovës
SUBJEKTI:	Raporti i auditimit për Komunën e Klinës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2020

Nr. Zyrës: No. de bureau:	Ext: Poste:	Data: 25.06.2021
-------------------------------------	-----------------------	-------------------------


Data	Zyra e Pranimit	Komentet/Veprimet	Inicialet	Afati
		<p>Bashkangjitur mund të gjeni raportin e auditimit për Komunën e Klinës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2020.</p> <p>Sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimi të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzoj një Plan Veprimi ku përcakton se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.</p>		

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
<http://zka-rks.org>


REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE			
DATE PRANUAR/DOKUZUAR: DATE RECEIVED / SUBMITTED:			
Nivoli Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code		



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

	Gradonačelnik Opštine Kline Skupština Opština Klina
Elektronski primerak:	Hykmete Bajrami, Predsedavajući KNJF i Koordinator KNJF Armend Muja, Predsedavajući KBRT i Koordinator KBRT
Od:	Besnik Osmani, Generalni Revizor, Republika Kosovo 
PREDMET:	Izveštaj revizije Opštine Kline za finansijsku godinu završno sa 31 Decembrom 2020

Br. Kancelarije: No. de bureau:	Ext: Poste:	Datum: 25.06.2021
--	------------------------------	--------------------------

Datum	Prijemna kancelarija	Komentari/Radnje	Inicijali	Rok
		<p>U prilogu možete naći Izveštaj revizije za Opštine Kline za finansijsku godinu završno sa 31 Decembrom 2020.</p> <p>Prema članu 23, stav 5 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnom Kancelariju Revizije, svaka revidirana institucija je obavezna da u roku od 30 od dana prijema završnog izveštaja podnese Akcioni Plan u kojem se određuje kako će adresirati preporuke koje su date u izveštaju.</p>		





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, qershor 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: z. Zenun Elezaj , Kryetar

Adresa: Sheshi "Mujë Krasniqi", Klinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Klinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Klinës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Kemi evidentuar se në dy raste, urdhër pagesat (CPO) në vlerë totale prej 17,866€ nuk ishin të nënshkruara nga zyrtari certifikues, ndërsa në shtatë raste urdhër pagesat (CPO) në vlerë prej totale 94,160€ nuk ishin të nënshkruara nga zyrtari shpenzues, pra nënshkrimi i pagesave ishte bërë nga zyrtar të paautorizuar.
- A2 Në 14 raste komuna nuk kishte lëshuar faturë për qiranë në vlerë totale prej 72,060€, përdërisa, njëri nga qiramarrësit e shfrytëzimit të banesës sociale nuk kishte kontrate me komunën.
- A3 Në tri pagesat e testuara në vlerë totale prej 22,500€ për muajt maj, gusht dhe shtator 2020 për kontratën "Ofrimi i shërbimeve shëndetësore shtëpiake", nuk kishte dëshmi se cilat shërbime shëndetësore janë ofruar nga OE.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Në tri raste janë realizuar pagesa në bazë të vendimeve gjyqësore në vlerë totale prej 12,836€ për pagat përcjellëse për dalje në pension si dhe për pagesën e shujtës për punëtorët e arsimit. Këto pagesa ishin realizuar nga kategoria mallra dhe shërbime, përkundër faktit që këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë paga dhe mëditje.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Klinës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Klinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Klinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Klinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Klinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalsjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Parregullsi procedurale në realizimin e pagesave

Gjetja

Ligji nr. 03/l-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 14 zytari certifikues, paragrafi 14.4 përcakton që "Zytari Certifikues është përgjegjës që a) të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës, b) të sigurojë që shpenzimi i parave publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me Rregullat e KMF. Gjithashtu, me rregullat e menaxhimit të financave publike çdo vit Thesari me aprovimin e ZKA së Organizatës e bënë emërimin dhe fletë deponimin e nënshkrimeve të personelit të caktuar dhe lejon qasjen në SIMFK.

Në procesin e pagesave kemi evidentuar se në dy raste, urdhër pagesat (CPO) në vlerë totale prej 17,866€ nuk ishin të nënshkruara nga zytari certifikues por nga një zyrtar tjetër, ndërsa në shtatë raste urdhër pagesat (CPO) në vlerë prej totale 94,160€ nuk ishin të nënshkruara nga zytari shpenzues por nga një zyrtar tjetër. Kryetari nuk kishte autorizuar zyrtar alternativ përkatës i cili do të zëvendësonte zyrtarët në mungesë të tyre.

Kjo ka ndodhur për shkak të pandemisë, ku zyrtarët gjatë kësaj periudhe kanë punuar me orar të reduktuar dhe nuk kishte ndonjë zyrtar alternativë që e zëvendëson pozitën e tyre gjatë kohës kur ishin në pushim qoftë zyrtari shpenzues /certifikues.

Ndikimi

Autorizimet për nënshkrime janë për persona të caktuar të cilët gjenerojnë dokumente nga SIMFK-ja dhe nënshkrimi i këtyre dokumenteve nga persona tjerë të pa autorizuar rrisin rrezikun që kontrollet të mos aplikohen dhe kjo mund të ketë efekt negativ që gjatë ekzekutimit të pagesave të rezultojnë edhe pagesa të pa rregullta.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pagesat realizohen pas nënshkrimit nga zyrtarët e autorizuar, po ashtu, duhet të siguroj që për çdo zyrtarë të autorizuar të kenë zyrtarë alternativë, në rast të mungesës së tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme jo sipas legjislacionit

Gjetja

Neni 26 Ligji nr.06_L-005 Për tatimin në pronën e paluajtshme përcakton se "Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kapitulli për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e 10€. Kurse neni 6 i kontratës për banesa sociale të lëshuara me qira përcakton "Shfrytëzuesi banesës duhet t'i kryej detyrimet e nevojshme për qira në afat prej 15 ditëve pas pranimit të faturës" po ashtu për shfrytëzuesit e lokaleve me qira neni 4 i kontratës përcakton që "Shfrytëzuesi i lokalit detyrohet që dhënësit të lokalit ti paguaj qiranë, në lartësi të përcaktuar me rregullore të aplikueshme që posedon Komuna e Klinës, dhe i njëjti duhet ti paguaj deri me datë 05 të fillimit të muajit, për muajin në vijim".

Në 14 nga 28 mostra të testuar konstatuam se komuna nuk kishte lëshuar faturë për qiranë në vlerë totale prej 72,060€, prej tyre, tri raste ishin për shfrytëzim të pronës publike, shtatë për shfrytëzim të lokaleve dhe katër për banesa sociale. Përderisa, njëri nga qiramarrësit e shfrytëzimit të banesës sociale nuk kishte kontrate me komunën.

Shkak i mos lëshimit të faturave për qiranë ishte neglizhenca e personave kompetent për dërgimin e faturave tek qira marrësit. Ndërsa mos lidhja e kontratës me komunën kishte ndodhur për shkak të mosveprimit të zyrës ligjore dhe drejtorisë së urbanizimit.

Ndikimi Mos lëshimi i faturave ndikon në mos realizimin e llogarive të arkëtushme dhe dëmtimin e buxhetit të Komunës. Kurse dhënia e banesës me qira pa kontratë krijon mundësin që komuna të mos arkëtoj fare borxhin nga qiramarrësi.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj se qiramarrësit marrin faturën për qira nga komuna si dhe të gjithë qiramarrësit të kenë kontrata. Po ashtu, për qiramarrësit që neglizhojnë ta paguajnë qiranë të ndërmerr veprime të menjëhershme për largimin e tyre nga pronat, lokalet dhe banesat komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mungesë e dëshmive për ofrimin e shërbimeve

Gjetja Sipas neni 1 të kontratës për "Ofrimin e shërbimeve shëndetësore shtëpiake" të nënshkruar me dt.24.02.2020 në vlerë 225,000€⁵, OE duhet të ofrojë ndër të tjerash: staf adekuat për ofrimin e shërbimeve në institucionet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike me theks të veçantë shërbime shëndetësorë shtëpiake, të angazhoj 15 punëtor të ndarë në dy grupe, në baza të rregullta të ofrojë asistencë teknike stafit ekzistues të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në punët e përditshme, në rastin e paraqitjes së epidemive/sëmundjeve ngjitëse në baza të rregullta të ofrojë raporte pune me aktivitete të shërbimeve dhe raportin vjetor, të dorëzoj raportin financiar çdo gjashtë muaj dhe të mundësoj realizimin e shërbimeve tjera deficitare shëndetësorë për komunën e Klinës etj.

Në tri pagesat e testuara në vlerë totale prej 22,500€ për muajt maj, gusht dhe shtator 2020 nuk kishte dëshmi se cilat shërbime shëndetsore janë ofruar nga OE. Më tutje, me kërkesë nga menaxheri i kontratës me dt.08.06.2020, OE kishte rritur numrin e punëtorëve edhe për katër (4), të cilët edhe ishin paguar gjatë vitit 2020. Përkundër pagesave të tyre nuk ka dëshmi se cilat shërbime i kanë ofruar ky staf shtesë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së komisionit për pranimin e shërbimeve i cili do të siguronte se shërbimet janë ofruar në pajtim me kontratën.

Ndikimi Realizimi i pagesave në mungesë të dëshmive se shërbimet janë realizuar sipas kontratës rrit rrezikun e pagesave për punë/shërbime të pa kryera dhe njëherësh ndikon në dëmtim të buxhetit. Po ashtu, ndryshimi i kushteve të kontratës në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik ndikon në keq menaxhim të parasë publike.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të bëjë një rishikim të zbatimit të kësaj kontrate për të siguruar se ofrimi i shërbimeve po zbatohet sipas specifikimeve të kontraktuara. Në raportet mujore të përgatitura nga OE duhet të përshkruhet në detaj secili shërbim i ofruar dhe se pagesat duhet të bëhen vetëm pasi të jetë marrë siguria/dëshmitë se shërbimet janë pranuar. Po ashtu, për rastet e pagesave në mungesë të dëshmive se janë ofruar shërbimet, duhet të shqyrtohet mundësia e kthimit të mjeteve në buxhetin e komunës. Kryetari duhet të sigurohet që të mos bëhen devijime dhe rritje indikativë në kriteret e kontratës në kundërshtim me legjislacionin.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet për pasqyrat financiare

Në vijim është çështja që ka të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 39,958€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

Në dy^e raste janë realizuar pagesa në vlerë totale prej 39,250€ për furnizim me pako ushqimore për raste sociale nga kategoria mallra dhe shërbime, përderisa këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve;

Në dy raste janë realizuar pagesa në vlerë totale prej 708€ nga investimet kapitale, përderisa këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbimeve.

Ndikimi Planifikimi jo i duhur i ndarjeve buxhetore sipas nevojave dhe objektivave që komuna pritët të përballet, ka ndikuar në klasifikim jo adekuat të shpenzimeve dhe prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke ofruar informata të gabuara për lexuesin.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të hyrat

Komuna për vitin 2020 kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 915,074€, nga të cilat ishin realizuar 778,587€ apo 85%. Këto të hyra janë kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, veprimtaritë biznesore, qiraja etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror (gjobat nga policia, gjykata dhe agjensioni i pylltarisë) në vlerë prej 196,430€.

Çështja B2 - Mangësi në bazën e të dhënave për tatimin në pronë

Gjetja

Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronë të paluajtshme, përcakton që "Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohe zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit", si dhe paragrafi 4 përcakton që "Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim 2 (dy) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme".

Bazuar në kërkesat e sistemit Protax, dosja e tatimpaguesit duhet të përmbajë elementet si në vijim: numrin personal ID, numrin e tatimpaguesit, pronës, ndërtesës, fotografi etj.

Nga mostrat e testuar dhe analiza e bazës së shënimeve të Protax-it, kemi konstatuar se numri i tatimpaguesve që përfitojnë nga zbritja pa e pasur dosjen e kompletuar është 938, ku 354 prej tyre nuk kanë të vendosur numrin e letërnjoftimi ndërsa 584 kanë të vendosur numra që nuk korrespondojnë me numër të letërnjoftimit të Republikës së Kosovës.

Më tutje, kemi identifikuar se 11 tatimpagues të tjerë janë përfitues në dy vendbanime parësore.

Shkaku i ndodhjes është neglizhenca e zyrtarëve kompetent për kompletimin e dosjeve të tatimpaguesve.

Ndikimi

Mangësitë e identikuara në bazën e të dhënave dhe informatat e mangëta në dosjen e tatimpagueseve përfshirë numrin personal, ndikon në mundësin e përfutimit të zbritjes së vendbanimit parësore në më shumë se një pronë.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të siguroj se dosjet e tatimpaguesve janë kompletuar bazuar në kërkesat e sistemit Protax.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 6,302,479€ i cili ishte shpenzuar në masën prej 99.8%. Numri i lejuar i stafit sipas buxhetit/planifikimit ishte 948 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 930. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 58,197€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Kompensim i parregullt i pagave

Gjetja Neni 9⁷ i UA - MAPL Nr.01/2018 ka definuar se “Zyrtarët nga neni 4,5,6 dhe 7 të këtij udhëzimi do të marrin pagat në bazë të legjislacionit për pagat në Republikën e Kosovës”.

Me vendim të kryetarit janë emëruar një asistent administrativ në zyrën e nënkryetarit të komunës, dhe një zyrtar për marrëdhënie me publikun në kuadër të zyrës së kryetarit. Pagat e tyre gjatë vitit 2020 në total ishin në vlerë 8,340€, të cilat janë realizuar nga kategoria mallra dhe shërbime (kodi ekonomik 14360-shërbime tjera kontraktuese).

Zyra e kryetarit bazuar në programin buxhetor të vitit 2020 nuk kishte pozita të lira po ashtu edhe me qarkoret buxhetore komuna është udhëzuar se nuk ka mundësi të rritjes së stafit. Komuna ka dërguar të plotësuar formularët për vendosjen e këtyre punëtoreve në listën e pagave mirëpo për shkak të kufizimeve të numrit të stafit, alternativë e vetme për kompensim ka mbet kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Ndikimi Kompensimi i parregullt i punonjësve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ndikon në mbivlerësimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime duke nënvlerësuar kategorinë e pagave dhe mëditje. Kjo reflekton në klasifikimin e gabuar të shpenzimeve të prezantuar në PFV për kategoritë përkatëse.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet paraprakisht të sigurohet se ka mundësi për rritje të stafit si dhe buxhet të lejuar me Ligjin e Buxhetit, me qëllim që kompensimi i këtij stafi të angazhuar të jetë i rregullt. Për shkak të kufizimeve, komuna duhet të parashtrij kërkesa të arsyeshme dhe nxis rritjen e numrit të stafit pranë organeve relevante, në të kundërtën kjo formë e pageses nuk është e rregullt dhe nuk duhet të vazhdojë

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 1,654,566€, prej tyre ishin shpenzuar 1,571,273€ apo 95% e buxhetit, këto shpenzime ishin kryesisht për blerje të mobilieve dhe pajisjeve, për shërbime kontraktuese, vendime të gjykatave, derivate si dhe riparime dhe furnizime. Kemi testuar 20 mostra për teste substanciale në vlerë 184,979€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Pagesa për shërbime të telefonisë mobile bazuar në kontratën me afat të skaduar

Gjetja Sipas nenit 26 të Rregullës Financiare 01/2013, 'Asnjë detyrim për pagesë nuk zbatohet nëse për të njëjtin nuk ekziston një dokument, marrëveshje apo aranzhim në bazë të cilit rezulton lindja e atij detyrimi'.

Komuna e Klinës nga muaji prill deri në fund të vitit 2020 kishte vazhduar me pranimin e shërbimeve dhe kryerjen e pagesave bazuar në kontratën "Shërbimet e telefonisë mobile për institucionet komunale" e cila kontratë kishte skaduar me dt.29.03.2020. Vlera totale e këtyre pagesa ishte 11,226€.

Për shkak, të mungesës të komunikimit në mes të Departamentit të prokurimit dhe Drejtorisë përkatës/Njësisë Kërkuese, nuk ishte ndërmarrë asnjë procedurë për të kontraktuar operator për këtë lloj të shërbimeve.

Ndikimi Pranimi dhe pagesa e shërbimeve bazuar në kontratën me afat të skaduar rrit rrezikun e pranimi të shërbimeve me çmime më të larta se çmimet e tregut.

Rekomandimi A4 Kryetari i komunës duhet të ndërmarrë masa që asnjë pagese të mos kryhet pa kontratë valide, po ashtu duhet të siguroj komunikim efektiv në mes njërive kërkuese dhe zyrës së prokurimit në mënyrë që procedurat e prokurimit të zhvillohen me kohë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Pranimi i barnave pa komision

Gjetja Neni 8 pika 4 e Rregullës Financiare 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare përcakton se, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) me vendim duhet të formojë Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare, i cili ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar.

Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se, në një pagesë për furnizim me barna në vlerë 21,703€, pranimi i tyre nuk ishte bërë nga komisioni për pranimin e mallit/furnizimit por nga zyrtarja e barnatores së QKMF-së në Klinë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos formimit të komisionit për pranimin e mallrave/furnizimeve nga ZKA.

Ndikimi Pranimi i mallrave/furnizimeve në mungesë të komisionit relevant të pranimi, rrit rrezikun e pranimi të mallrave/furnizimeve jo sipas sasisë dhe cilësisë së kontraktuar.

Rekomandimi A5 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që komisionet përkatëse për pranimin e mallrave/furnizimeve janë caktuar me kohë dhe se të gjitha pagesat bëhen bazuar në raportet e pranimi sipas rregullave të përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 279,157€, prej tyre ishin shpenzuar 211,598€. Komuna kryesisht ka mbështetur aktivitetet kulturore, sportive si dhe ka ndihmuar bujqit, fermerët dhe qytetaret në nevojë. Kemi testuar pesë mostra për teste substanciale në vlerë 56,575€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A6 - Subvencionimi i projekteve në mungesë të propozim buxhetit të detajuar

Gjetja Neni 11 paragrafi 1.2 i rreg.MF-nr.04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, përcakton që "Projekt propozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike". Pra, kërkuesi i subvencioneve sipas rregullores dhe thirrjes publike obligohet të plotësojë Formularin 10/Formën e buxhetit me zërat e linjave buxhetore ku ai do të shpenzoj buxhetin e planifikuar për shpenzim dhe për çdo zë buxhetor duhet të prezantohet dhe llogaritet lloji i shpenzimit, çmimi për njësi për çdo aktivitet dhe shpenzimi total.

Në pesë (5) mostra konstatoam se, OJQ-të përfituese në formular kanë paraqitur vetëm koston totale sa kërkojnë buxhet për mbështetje financiare, duke mos prezantuar zërat e linjave buxhetore për shpenzim dhe as llogaritur çmimi për njësi.

Kjo ka ndodhur nga neglizhenca e komisionit të vlerësimit të cilët nuk kanë marrë parasysh kërkesat e rregullores me rastin e vlerësimit dhe ndarjes së subvencioneve.

Ndikimi Subvencionimi i OJQ-ve në mungesë të propozim buxhetit lidhur me paraqitjen e zërave dhe aktiviteve se ku do të shpenzohen mjetet dhe pa u bërë llogaritja e çmimeve për njësi dhe koston, rrit rrezikun që përfituesi i subvencionit të mos i shpenzoj mjetet në përputhje me objektivat e përcaktuara.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të siguroj përmes komisionit të vlerësimit se përfituesit e subvencioneve gjatë aplikimit kanë shpalosur në detaje të gjitha kërkesat në Formularin 10.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve

Gjetja Gjatë testimit të mostrave për subvencione kemi identifikuar dobësitë si në vijim:
Sipas nenit 6 të Rreg. MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve (Plani Vjetor i Mbështetjes Financiare) kërkohet që: "Ofruesit e mbështetjes financiare të përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit". Po ashtu, sipas neni 23 paragrafit 1 (Monitorimi dhe raportimi i projekteve dhe programeve) i të njëjtës rregullore kërkohet që: "Për secilën kontratë të

lidhur, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Ndërsa 23 paragrafit 2 përcakton që përfituesi të raporton te zyrtari monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit, sipas kërkesave të kontratës".

Komuna nuk kishte përgatitur plan vjetor për vitin 2020 të mbështetjes financiare për OJQ-të. Komuna e Klinës e cila ofron mbështetje financiare për OJQ-të, kishte dështuar në përgatitjen e planit vjetor.

Nga mostrat e testuara kemi konstatuar se komuna nuk ka caktuar zyrtar përgjegjës për monitorim dhe mbikëqyrje të implementimit të projekteve, po ashtu, në tre (3) raste në vlerën totale prej 29,300€, përfituesit e subvencionit nuk kanë raportuar lidhur me zbatimin e projektit/programit.

Zyrtaret e komunës kanë kërkuar në vazhdimësi (edhe me shkrim) që të raportohet nga përfituesit, duke e paralajmëruar edhe për mundësin e ndërprerjes së financimit në të ardhmen.

Ndikimi

Mos përgatitja e planit vjetor të mbështetjes financiare si dhe mungesa e monitorimit dhe raportimit lidhur me zbatimin e projektit rrisin rrezikun që mjetet e dhëna për mbështetje financiare të mos arrijnë qëllimin apo të përdoren në mënyrë të parregullt nga përfituesit.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të siguroj se, drejtoritë përkatëse përgatisin plan vjetor për subvencionim të OJQ-ve, si dhe, të siguroj se të gjithë përfituesit raportojnë në mënyrë të rregullt lidhur me implementimin/realizimin e projekteve, dhe për të gjithë ata që nuk raportojnë të marre vendim që mos të jenë përfitues të subvencioneve në thirrjet publike pasuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,006,620€, prej tyre ishin shpenzuar 2,844,159€. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, trotuareve, ndërtimin e objekteve, blerje të pajisjeve, automjete etj. Kemi testuar 38 mostra për teste substanciale në vlerë 1,341,112€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B5 - Vonesa në realizimin e kontratave

Gjetja

Sipas nenit 81 të LPP nr.05/L-068, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik pikat 61.6,61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojë se OE e realizon kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Në dy (2) raste komuna nuk kishte realizuar punimet sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë, pra kishte vonesa domethënëse në progresin fizik në këto projekte:

- Ndërtimi i Sheshit – Rrugëve në qytet – Infrastruktura nëntokësore dhe mbitokësore, vlera e kontratës 1,423,329€ e dt.28.12.2015 duhej të përfundonte brenda 360 ditë pune;
- Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në qytet, vlera e kontratës 198,438€ e dt.31.07.2019, duhej të përfundonte brenda 100 ditësh pune.

Në këto dy projekte ende nuk kishin përfunduar punimet, ku sipas zyrtarëve përgjegjës shkaktar i vonesave në realizimin e këtyre projekteve ishte mungesa e buxhetit dhe kontestet pronësore juridike.

Ndikimi

Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që komuna të mos arrijë objektivat e përcaktuara dhe në mungesë të fondeve buxhetore për vitet pasuese, projektet e filluara mund të mos përfundohen edhe një kohë. Në anën tjetër, kjo situatë mund të ndikojë që OE të ushtrojnë padi gjyqësore ndaj Komunës për shkak të mos përgjegjësisë ndaj zbatimit të projekteve apo kryerjes së obligimeve me kohë ndaj OE.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë se para nënshkrimit të kontratës janë zgjidhur kontestet eventuale pronësore dhe të sigurohet se ka buxhet të mjaftueshëm për realizimin e kontratës sipas planit dinamik. Po ashtu, duhet të shtohen masat e kontrollit dhe në rastet kur ka vonesa të paarsyetuara të aplikohen penalet për ditët me vonesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Ndryshimi i pozicioneve të paramasës jo në pajtueshmëri me procedurat ligjore.**Gjetja**

Dosja e tenderit dhe kontrata përcaktojnë se projektet duhet të realizohen sipas paramasës dhe para llogarisë, ku furnizimet/punët duhet të jenë në përputhje me sasinë dhe cilësinë e përcaktuar me kontratë. Po ashtu, LPP përcakton se menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE realizon kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Më tutje, sipas "Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik" paragrafit 61.20 pika g dhe h përcaktojnë Funkcionet e Menaxherit të Projektit të cilat janë: Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin nga ky departament.

Tek kontrata për "Renovimin e QKMF në sallë të konferencave – Zhvillim i vazhdueshëm profesional dhe në mjekësi familjare dhe specialistike" në vlerë totale 9,303€, gjatë ekzaminimit fizik të punimeve të realizuara kemi konstatuar se punimet nuk ishin realizuar sipas kontratës. Nga 20 pozicione të kontraktuara, nëntë prej tyre ishin ndryshuar^a, aprovimi i ndryshimeve ishte bërë vetëm verbalisht nga menaxheri i kontratës. Situacioni për punët e përfunduara në bazë të cilit ishte realizuar edhe pagesa ishte aprovuar nga menaxheri i kontratës bazuar në pozicionet e kontraktuara e jo në bazë të pozicioneve të realizuara.

Planifikimi dhe hartimi jo-adekuat i projektit nga ana e komunës, ka shtyrë që të ndryshohen pozicionet brenda paramasës së kontraktuar. Gjithashtu, mungesa e njohurive rreth kërkesave ligjore nga ana e Menaxherit të projektit ka bërë që mos të ndiqen procedurat përkatëse ligjore me rastin e ndryshimit të pozicioneve.

Ndikimi

Ndryshimi i pozicioneve të përcaktuara paraprakisht në marrëveshje kontraktuale pa ndjekur procedurat ligjore përbën shkelje të Kontratës dhe si e tillë rrit rrezikun që Operatori Ekonomik të mos kryej punët sipas standardeve dhe cilësisë së përcaktuar në paramasë.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë se përcaktimi i saktë i nevojave dhe specifikimi i punëve duhet të përgatitet dhe projektohet para fillimit të tenderimit dhe në monitorimin e kontratave si organ mbikëqyrës, të përfshihet stafi kompetent që janë të njoftuar me përgjegjësit e përcaktuar me LPP. Nëse paraqitet nevoja për ndryshim të termeve dhe kushteve të kontratës, organi mbikëqyrës duhet të inicioj dhe arsyetoj pranë zyrës së prokurimit këto ndryshime dhe të marrin aprovimet nga nivelet relevante-ZKA.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B7 - Investime publike në parcelat e pa shpronësuara****Gjetja**

Neni 4 pika 2.4.3.1 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, përcakton se "Organi Shpronësues i Komunës mund të bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm nëse ndërlihet me rrugët komunale (rrugët të cilat shtrihen tërësisht brenda komunës) të cilat ofrojnë shërbime të transportit për publikun".

Gjatë testimit të projekteve kapitale të realizuara për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Dollovë, Grabanicë, Dush dhe Jellovë⁹, kemi vërejtur se investimet përkatësisht asfaltimi i rrugëve ishte duke u realizuar në pronë private. Komuna kishte marrë pëlqim nga pronarët e tokave për të realizuar investimin, por nuk kishte ndërmarrë asnjë procedurë ligjore që pronat në të cilat po kryhen investimet të kthehen në pasuri të komunës sikur edhe parashihet me ligjet në fuqi.

Sipas zyrtarëve të komunës nëse do të zhvilloheshin procedura të shpronësimit do të rriteshin kostot për komunën dhe në këtë mënyrë do të zvogëlohej mundësia financiare e komunës për të investuar në projekte kapitale.

Ndikimi

Realizimi i projekteve të tilla rrit rrezikun që vlera investive e tyre të mos i dedikohet interesave të gjëra të qytetarëve dhe se komuna rrezikon të përballet me padi në të ardhmen nga pronarët e parcelave, ku përveç kompensimit të shpronësimit do të shkaktohen edhe shpenzimet tjera shtesë.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë që është ndarë buxhet për shpronësim të parcelave dhe çështjet pronësore të trajtohen në bazë të dispozitave ligjore para inicimit të tenderimit për ekzekutim të projekteve kapitale - ndërtim/zgjerim të rrugëve dhe infrastrukturë tjetër.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.7 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 68,201,615€, pasurive jokapitale është 666,236€, si dhe e stoqeve 643€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 1,097,711€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B8 - Mangësi në evidentimin e pasurive jo financiare

Gjetja Sipas Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare përkatësisht neni 6, paragrafi 3 "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria."

Pasuria kapitale¹⁰ (mbi 1,000€) ishte nënvlerësuar për 17,500€ , pasi që një pages nuk ishte regjistruar në SIMFK, edhe pasuria jo kapitale (nën 1,000€) ishte nënvlerësuar për 995€, si rezultat i mos regjistrimit të këtyre pasurive në sistemin e-pasuria.

Shkaku i regjistrave jo të plotë ishte neglizhenca e stafit dhe mungesa e një analize mbi plotësinë në regjistrat kontabël.

Ndikimi Regjistri jo i plotë i pasurive, rezulton me mangësi informatash për pasuritë dhe raportim jo të drejtë të tyre. Po ashtu, rrit rrezikun e humbjes dhe tjetërsimit të tyre.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë se, zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe mirëmban regjistrat e pasurisë që disponon komuna.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mungesa e hapësirave për deponim të materialit shpenzues

Gjetja Sipas Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare përkatësisht neni 8, pika 2 "Pranimi i pasurisë financiare përcakton që pranimi i pasurive jo financiare në depo duhet të bëhet në bazë të fletëpranimit përkatës të nënshkruar nga Zyrtari i Pranimit/Logjistikes, pas verifikimit të sasisë, vlerës dhe cilësisë që i referohen kushteve me kontratë apo të urdhër blerjes. Për rastet kur pranimi i pasurisë jo financiare bëhet drejtpërsëdrejti nga furnitori te përdoruesi pa kaluar nga depoja qendrore, Zyrtari Kryesor Administrativ duhet të aprovoj procedura të qarta të pranimit duke përcaktuar përgjegjësinë përkatëse të menaxhimit dhe përdorimit.

Komuna nuk posedon depo funksionale përmes së cilës do të bëhej ngarkimi/shkarkimi me material zyrtar dhe mund të mbahen stoqet e materialit për zyre apo pajisjeve rezervë. Furnizimet pranohen nga zyrtari i pranimit dhe menjëherë dorëzohen tek Drejtoritë si njësi kërkuese. Nuk ka dëshmi se si bëhet shpërndarja e materialit nga drejtoria tek zyrtaret dhe për këtë arsye gjendja e stoqeve nuk mund të dihet me saktësi.

Mungesa e hapësirës së nevojshme ka qenë arsye pse nuk është funksionalizuar depoja.

Ndikimi Mungesa e procedurave të brendshme për ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë mund të ndikoj që pasuria e komunës të mos menaxhohet si duhet dhe të mos prezantohet drejtë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë funksionalizimin e depos që të mundësohet mbajtja e evidencave të sakta për gjendjen e stoqeve në çdo kohë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C2 - Mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistra kontabël

Gjetja

Sipas Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare përkatësisht neni 19, pika 4.3 përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare është edhe 'Krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë jo financiare', po ashtu sipas paragrafi 6 të kësaj rregulloreje "Të gjitha ndryshimet në numrin ose vlerën e pasurive të cilat përcaktohen pas inventarizimit duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël". Po ashtu, sipas nenit 20 "Organizata buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiar për të vërtetuar njësojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës".

Lidhur me këtë kemi konstatuar se:

- Raporti për inventarizimin e pasurisë ishte përgatitur dhe dorëzuar me kohë, por komisioni përgjegjës nuk kishte harmonizuar gjendjen e inventarizimit me gjendjen e pasurisë në regjistra kontabël; dhe
- Komuna kishte themeluar komisionin për vlerësimin e pasurive pas përfundimit të vitit si nevojë e dalë nga raporti i inventarizimit të pasurive jo financiare. Megjithatë, komisioni nuk kishte arritur të bëjë vlerësimin e pasurive sikur parashihet në kërkesat ligjore.

Shkaku i mos harmonizimit ishte mungesa e informatave se një gjë e tillë duhet të ndodh, gjithashtu mungesa e regjistrave të plotë në vitet paraprahe ka pamundësuar harmonizimin përkatës. Ndërsa mos vlerësimi i pasurisë ishte pasojë e neglizhencës së komisionit përkatës.

Ndikimi Mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël si dhe mos vlerësimi i pasurisë rrisin rrezikun që pasuritë të keqpërdoren, humben apo të tjetërsohen, si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë se puna e komisionit të inventarizimit dhe komisionit të vlerësimit është kryer me përgjegjësi të plotë dhe para përpilimit të PFV për vitin 2021. Implementimi i këtij procesi duhet të reflektojë me krahasimin ndërmjet inventarizimit dhe gjendjes së pasurisë të mbajtur në regjistrat kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.8 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,622,877€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 1,685,563€, licenca të bizneseve 692,467€, qiratë e banesave 131,714€, qiratë e lokaleve 97,191€, shfrytëzimi i pronës publike 14,667€ dhe qiratë nga tregu i hapur 1,275€.

Çështja B9 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Komuna nuk ka arritur të përgatit një plan operativ për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe nuk ka ndërmarr veprimet e kërkuara sipas legjislacionit.

Llogaritë e arkëtueshme krahasuar me vitin e kaluar janë rritur për 389,999€ (apo në masën prej 15%), rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë si dhe tek pronat e dhëna me qira.

Shkaqet e rritjes së të arkëtueshmeve janë veprimi i pamjaftueshëm i komunës, që përmes organeve të drejtësisë të zvogëlojë borxhin e pa mbledhur nga klientët.

Ndikimi Rreziku i mos arkëtimit të të hyrave ndikon në dëmtimin e buxhetit të komunës. Mungesa e kontrollit dhe mos veprimi i komunës pamundëson arkëtimin dhe rrit rrezikun e vjetërimit të llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbauesve për ulje të llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.9 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të pa paguara në fund të vitit 2020, ishte 131,646€ , krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje të lehtë prej 2,772€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021.

Çështja B10 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Neni 39 i LMFPP përcakton: "Afatin e pagesës brenda 30 ditëve nga pranimi i faturës".

Në pesë (5) raste në vlerë totale prej 13,737€ kishte vonesa mbi 30 ditë në pagesën e faturave të pranua, vonesat variojnë nga 37 deri 252 ditë kalendarike.

Sipas zyrtarëve kjo gjendje është krijuar në mungesë të mjeteve buxhetore.

Ndikimi Hyrja në obligime pa mbulesë të mjeteve dhe vonesat në pagesa mund të ndikojë në rritjen e obligimeve të cilat krijojnë implikime buxhetore për vitin vijues dhe rrezikojnë të shkaktohen shpenzimeve shtesë për shkak të pagesave sipas vendimeve gjyqësore/përmbarimore.

Rekomandimi B10 Kryetari duhet të ngritë kontrolle shtesë për tu siguruar se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve të papaguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne i kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹⁾	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	11,054,139	11,720,086	10,780,214	10,105,744	9,487,637
Grante Qeveritare – Buxheti	10,139,065	10,347,446	9,918,994	8,907,482	8,436,608
Financimi përmes huamarrjes	0	73,710	73,710	98,650	0
